

VENDIM
Nr. 456, datë 22.5.2013

**PËR PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR
TË SHËNDETIT MENDOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Kombëtar të Shëndetit Mendor, në vijim KKSHM, i cili të kryesohet nga Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Drejtuesin e njësisë që mbulon çështje të shëndetit publik në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Drejtuesin e njësisë që mbulon çështje të planifikimit spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Drejtuesin e njësisë që mbulon çështje të planifikimit financiar në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Drejtuesin e njësisë që mbulon çështjet juridike;
- Shefin e Shërbimit të Psikiatrisë në QSUT;
- Drejtorin e Spitalit Psikiatrik Elbasan;
- Drejtorin e Spitalit Psikiatrik, Vlorë;
- Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Shkodër;
- Përfaqësues nga qendrat komunitare të shëndetit mendor, ASHR-së Tiranë;
- Përfaqësuesin e Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor;
- Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- Përfaqësuesin e Avokatit të Popullit;
- Përfaqësues nga Policia e Shtetit.

2. Në mbledhjet e KKSHM-së ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga përdoruesit/familjarët e përdoruesve të shërbimeve të shëndetit mendor, si dhe nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë, që kanë zyrat e përfaqësimit në Shqipëri dhe janë të interesuar për çështje të shëndetit mendor.

3. Kryetari i KKSHM-së ka këto detyra:

- përfaqëson KKSHM-në;
- vendos për rendin e ditës së mbledhjeve;
- planifikon dhe organizon mbledhjet;
- thërret dhe drejton mbledhjet e Komitetit.

4. Sektori i shëndetit mendor dhe adiktologjisë në Ministrinë e Shëndetësisë, shërben si sekretariat teknik i këtij Komiteti dhe kryen këto detyra:

- a) merr të gjitha masat organizative për përgatitjen e mbledhjeve të Komitetit;
- b) informon me shkrim të gjithë anëtarët e Komitetit për mbledhjet e ardhshme dhe u dërgon të gjitha dokumentet;
- c) mban procesverbalin e mbledhjeve;
- ç) dërgon procesverbalin e mbledhjes brenda 7 (shtatë) ditëve nga mbajtja e mbledhjes;
- d) informon anëtarët e Komitetit për ditën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjeve të jashtëzakonshme;
- dh) mban dokumentacionin e KKSHM-së.

5. KKSHM-ja këshillon Ministrinë e Shëndetësisë për:

- a) zbatimin e legjislacionit për shëndetin mendor;
- b) zhvillimin e politikave të Ministrisë së Shëndetësisë për shëndetin mendor;
- c) reformat që duhen ndërmarrë në fushën e shëndetit mendor;
- ç) ndërmarrjen e nismave ligjore e nënligjore për shëndetin mendor;

d) çështje të ndryshme që lidhen me organizimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të shëndetit mendor;

dh) monitorimin e zbatimit të planit të veprimit të zhvillimit të shërbimeve të shëndetit mendor, 2013-2022.

6. Komiteti Kombëtar i Shëndetit Mendor mbledhet rregullisht 2 herë në vit ose, për çështje të veçanta, thirret nga kryetari apo shumica e anëtarëve. Ai drejtohet nga kryetari ose zëvendësi i deleguar prej tij. Mbledhjet e KKSHM-së zhvillohen kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve.

7. Komiteti Kombëtar i Shëndetit Mendor shqyrton vlerësimet, komentet dhe sugjerimet e bëra nga misione të ndryshme vendase e ndërkombëtare dhe këshillon ministrin për zgjidhjet e problemeve që prekin të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor.

8. Raportet, deklaratat, opinionet e rekomandimet e KKSHM-së miratohen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij dhe botohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha